FON
UNIVERSITY

FON Info

FAKULTETI I SHKENCAVE POLITIKE, DIPLOMACISË DHE GAZETARISË

www.fon.edu.mk

PROF. DR. NANO RUZHIN, DEKAN I FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE, DIPLOMACISË DHE GAZETARISË

Bashkëpunimi me studentët funksionon si orë zvicrane

Nano Ruzhin ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Beograd dhe më pas vazhdoi studimet në Paris, Francë.

Në vitin 1980 pranohet ne Fakultetin e Sorbonës në Paris ku e vazhdon përgatitjen e magjistraturës së paraqitur në Fakultetin e Shkencave Politike (FSHP) në Zagreb.

Në vitin 1981 pranohet në Institutin e Shkencave Politike në Paris, kurse në vitin në vijim magjistron në FSHP në Zagreb. Më vonë e paraqet disertacionin e doktoraturës në Paris në Institutin francez për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Doktoron në Fakultetin Juridik në Shkup para komisionit ndërkombëtar në vitin 1986.

Më 1987 pranohet si docent i Fakultetit Filozofik, Katedra e Punës dhe Politikës Sociale.

Më 1993 i shkruan librat e para për këtë problematikë. Paralelisht vazhdon me kontaktet e tij ndërkombëtare me institutet shkencore ndërkombëtare franceze, ku dhe bëhet anëtar i Institutit të afirmuar IFRI dhe visiting-profesor i Sorbonës dhe i Institutit për Shkenca Politike në Paris.

Marrëdhëniet ndërkombëtare i ka ligjëruar në vitet e 90-ta në Fakultetin Juridik dhe në atë të Shkencave Politike në Shkup.

Temat primare të interesit të tij shkencor, gjithsesi janë shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare, BE dhe NATO, si dhe temat sociale nga rrafshi i politikës sociale dhe sigurimit social.

Pas qëndrimit 7 vjeçar si ambasador në NATO gjatë viteve 2001-2008, kthehet në Maqedoni, në Fakultetin Filozofik, prej ku nga qershori i vitit 2009 vendos që angazhimin e tij profesional ta vazhdojë në Universitetin FON, ku edhe zgjedhet si dekan i Fakultetit të Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë.

Në karrierën e tij kërkimore-shkencore në shkencat politike dhe në politikën sociale Nano Ruzhin ka botuar mbi 15 libra nga të cilat dallohen "Katër libra nga politika sociale dhe sistemet paralele nga mbrojtja sociale", "E drejta sociale evropiane", "Ideja evropiane nga utopia në realitet" dhe "NATO para sfidave të reja dhe perspektivat e RM-së". Gjithashtu, ka botuar edhe dy fjalorë të FARE-s për termat sociale dhe politike.

Njëherit është edhe autor i shumë shkrimeve profesionale brenda dhe jashtë vendit, kurse në vitin 2008 në Bruksel është shpallur ambasador i vitit 2007 në BE.

- Profesor Ruzhin, cilat ishin motivet për ardhjen tuaj në FON? A ka dallim në mësimdhënie dhe në konkurencë?

Ambienti në Universitetin FON më rikujton Fakultetin për Shkenca Politike në Paris në rrugën Sent Gijon. Para së gjithash, e ndjeva demokracinë intelektuale të studentëve dhe të profesorëve, si dhe sjelljen profesionale në mes tyre. Hasa në një trup menaxhues, të rinj dhe ambiciozë me botëkuptime evropiane bashkëkohore, si dhe në një ndjenjë fleksibiliteti në hierarki, e cila insiston më tepër në ndërgjegje se sa në sjellje të ashpra administrative që ekzistojne në universitetet e tjera, ose, pra nga ana



Profesor d-r Nano Ruzhin

tjetër, angazhimi jo i detyrueshëm që për momentin sundon në universitetin shtetëror. Atje profesorët dhe studentët ndjehen të harruar dhe mundohen të plotësojnë minimumin e obligimeve që kërkohen nga ata. Respekt për rastet që janë përjashtim i kësaj.

Elementi i tretë i rëndësishëm është plan-programi mësimor, i cili është i konceptuar sipas katedrave më të fuqishme euroamerikane.

Plamprogrami mësimor gjithmonë rishikohet me një vështrim kritik, ai plotësohet dhe përsoset. Në kompletimin e plan-programit mësimor, janë përfshirë të gjithë profesorët dhe asistentët e fakultetit.

Thjeshtë, tërë universiteti funksionon si një ekip, si një familje në harmoni me 300 antarë. I gjithë kuadri është i ndërgjegjshëm se mekanizmi i përbashkët i FON-it duhet patjetër të vazhdojë të funksionojë si një orë e përsosur dhe e gjithë kjo në funksion të studentëve.

- A ka homogjeni ndërmjet studentëve dhe kuadrit mësimor?

Praktikisht, studenti është në qendër të vëmendjes në gjithë Universitetin FON si dhe në Fakultetin e Shkencave Politike.

Ky homogjenitet është edhe baraspeshë ndërmjet kuadrit mësimor, adminmistratës dhe studentëve, ky funksionalitet është një energji krijuese në të mirën e studentëve dhe ekziston vetëm në këtë universitet.

- Sipas jush, ku i shihni studentët pas mbarimit të studimeve në Fakultetin e Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë?

I madh është numri i studentëve të cilët kaluan procesin edukativo-arsimor të Fakultetit Filozofik, Juridik dhe atij Politik, si dhe ata të FON-it. Disa nga ata i kam takuar në diplomaci, në MPJ, disa si funksionarë, sekretarë shtetërorë, si dhe këshilltarë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, disa të tjerë janë gazetarë të suksesshëm, deputetë, këshilltarë, funksionarë partiakë, biznesmenë të njohur, profesorë dhe asistentë të fakulteteve në vend dhe jashtë vendit.

- A mbretëron demokracia në plan-programin mësimor deri sa mësojnë, a e ndjejnë këtë studentët?

Shkencat politike janë shkenca specifike dhe që nga kontakti i parë me studentët e mi, ata kalojnë në disa faza të pjekurisë intelektuale.

Para së gjithash, në fazën e parë të njohjes ne mundohemi që ata t'i lirojmë në mënyrë që të kenë një qasje demokratike aktive ndaj profesorit dhe mësimdhënësve tjerë.

Kur do të vërtetohemi se fazën e komunikimit të lirë e kanë kaluar me sukses, atëherë fillon faza e dytë, ajo e stimulimit të studentëve që ata të jenë të lirshëm dhe të zhvillojnë mendimin kritik. I stimulojmë që të parashtrojnë pyetje të ndryshme dhe të mundohen që përmes kritikës të shprehen për atë se si profesori ligjëron ligjëratën, si dhe në mënyrë kritike të analizojnë ndodhitë në rrethin e tyre. Jemi këmbëngulës në sjelljen e tyre në një shkallë më të lartë të mendimit kur edhe duhet të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike para autoriteteve dhe dogmave të panjohura dhe të njohura.

Në këtë fazë të tretë, politikologu fillon në një dozë të madhe të kritikës të pranojë të gjitha ndodhitë politike dhe prezantimet profesionale.

Pra, qëllimi është që studentët t'i

edukojmë dhe t'i vetëdijësojmë dhe praktikisht tek ata të inkorporojmë një mëkanizëm evropian të vlerave. Mundohemi të krijojmë akademikë të vërtetë evropianë, me një shpirt kritik, i cili do të posedojë intelekt të fuqishëm.

Pra, qëllimi i idesë evropiane na mëson në vetëkritikën dhe idenë e lirë të frymëzimit evropian. Përfundimisht, në fazën e ardhshme ata vetë do të përparojnë që më pastaj t'ua kalojnë edhe mësimdhënësve të tyre.

- Ju jeni nga ata të cilët janë gjithmonë prezentë te studentët, i shihni si rriten, a jeni të kënaqur nga kualiteti dhe përgatitja e tyre?

Studentët të cilët studiojnë në Fakultetin e Shkencave Politike në FON, mundohen që në mënyrë sa më aktive t'u përgjigjen obligimeve që i kanë me mësimdhënësit. Gjerësia e garës së tyre intelektuale është e dukshme në më shumë nivele. Tash më në këtë periudhë kohore shihet se çfarë afiniteti kanë studentët në raport me dosjet e ndryshme nga domeni i shkencave politike. Secili student ka mundësinë e vetme që të tregojë superioritetin individual dhe të punojë në tema për të cilat ka afinitet të veçantë dhe përfundimisht në të njëjtën edhe të magjistrojë apo të doktorojë.

Konkurenca dhe rivaliteti ekzis-

ton, por falë mendimit kreativ. Sistemi i këtij universiteti është që më të mirët gjithmonë të shpërblehen dhe stimulohen për arritje edhe më të mëdha.

- Pyetje para së cilës nuk mund t'i mbyllim sytë. Vallë, a ekziston dallim me konkurrencën?

Dallimi në krahasim me konkurrencën e fakulteteve të shkencave politike në shtet është i shumëllojshëm. Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë është e vetmja katedër e këtij lloji në shtet me status të veçantë, ku edukohen dhe arsimohen politikologët, diplomatët, analistët dhe gazetarët e ardhshëm. Me rëndësi të vëçantë është përgjegjësia dhe profesionaliteti i kuadrit mësimor kundrejt mësimdhënies dhe studentëve, qasja e lirë e secilit student para profesorit dhe dekanit si dhe zgjidhja e pyetjeve me rëndësi përmes dialogut.

Derisa në disa fakultete as profesorët nuk kanë qasje para dekanit, në Fakultetin e Shkencave Politike, Diplomacies dhe Gazetarisë në Universitetin FON privilegjin që të dëgjohet zëri i studentit, e ka secili student qoftë i rregullt, apo me korrespodencë , i diplomuar apo posdiplomik.

VEPRIMTARIA E DERITANISHME

Hapësira evropiane e arsimit të lartë zhvillohet mbi traditat evropiane të arsimit si pergjegjësi publike, me një spektër të hapur ndaj studimeve dhe mënyrës së studimeve, por edhe i hapur ndaj zhvillimit dhe mësimit të përjetshëm mbi themelet e vlerave qytetare.

Gati se të gjitha universitetet e afirmuara në Evropë dhe në botë në kuadër të rrethit të vet bazohen mbi principin e autoritetit akademik dhe përgjegjësisë.

Si institucione arsimore autonome universitetet e vërtetojnë orientimin e vet sipas rregullës: "Magna Karta Universitatum" nga viti 1988, ku potencohet aksioma "liria akademike". Institucionet e larta arsimore i pranojnë sfidat që të veprojnë në një rreth me plot konkurrencë në shtetet e tyre në Evropë dhe në botë.

Hapësira evropiane e arsimit të lartë duhet të ndërtohet mbi themelet e vlerave akademike, të favorizojë kualitetin dhe të bazohet në qëllimet dhe detyrat që dalin nga programi që e krijoi procesi i Bolonjës. Kjo do të thotë një baraspeshë ndërmjet inovacionit dhe traditës, përsosmërisë akademike dhe shoqërisë ekonomike të balansuar në mes planeve mësimiore dhe programeve, lirisë dhe gjithashtu zgjedhjes së studentit.

Vlerësimi i kualitetit nënkupton mësimin, hulumtimin, administrimin dhe drejtimin si dhe mirëkuptimin për kërkesat e studentëve dhe për nevojat e tyre arsimore. Nuk është e mjaftueshme të kuptohet vetëm kualiteti, ai duhet të tregohet dhe të garantohet që më pastaj të pranohet në mes partnerëve në shoqëri, Evropë dhe botë që edhe ata të kenë besim.

Në kuadër të Universitetit FON një ndër fakultetet më të rëndësishme është Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacies dhe Gazetarisë, i cili deri në një kohë ekzistonte si drejtim i Fakultetit Juridik dhe Shkencave Politike, kurse më vonë u formua si fakultet i veçantë. Studimet në shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare sot janë më të rëndësishëmet në botë. Me dhjetra mijëra studentë i zgjedhin mu këto studime qofshin ato në Universitetin në Sanfort, Harvard, Kolumbi, SHBA, Haldeberg të Gjermanisë ose Sarbonë në Paris ose në Oxford, me dhjetra mijë studentë në botë në këtë mënyrë e fillojnë karrierën e tyre profesionale-shkencore, hulumtimet diplomatike, politike, publicistike ose karrierë gazetari.

Fakulteti ynë u mundëson mu këto kushte studentëve tanë nga Maqedonia dhe regjioni, studimet politikologjike të cilat janë të drejtuara dhe të specializuara, me to përfitohen njohuri teorike dhe metodologjike, si dhe përvojë praktike dhe trajnime për gjuhë të huaja që është me rëndësi të veçantë për diplomacinë.

Praktika zhvillohet në përfaqësitë diplomatike, në institucionet shtetërore, në ato publike dhe në media. Me këto studime hapen mundësi të reja që kanë domethënie të re dhe po ashtu një sfidë për kandidatët, por edhe një kualitet të punës së përgjithshme në fakultet.

Në vitin 2001 më tepër se 300 institucione arsimore evropiane së bashku me krerët e lartë, në Sallamanka të Spanjës e përgatitën përmbajtjen për takimin e paqes, të ministrave të arsimit që vinin nga shtetet që u kyçën në procesin e Bolonjës.

Në fakultet studiojnë afër 640 studentë, kurse gjatë vitit akademik diplomojnë prej 60-90 studentë. Mësimdhënia zhvillohet sipas sistemit 3+1+1, kurse për regjistrim të studentëve të rinj në vitin akademik 2010-2011 janë paraparë modulet: shkenca politike, diplomacia dhe gazetaria. Programet studimore dhe lëndore janë të inspiruara dhe e ndjekin kartën e Bolonjës, si dhe sistemin evropian të transferit të kredive (ECTS), model ky që siguron standardet bashkëkohore

evropiane të studimeve të larta si dhe edukimin e studentëve të këtyre tre fakulteteve.

Karakteristikë e këtij modeli është krijimi i profileve profesionale të arsimit të lartë me qëllim që të jenë konkurentë në tregun evropian të punës, përmes studimeve që mundësojnë grada më të larta, si dhe mobilizim gjatë procesit të studimeve.

Më 2001 më teper se 300 institucione të larta arsimore evropiane dhe krerët e tyre të larta në Sallamanka të Spanjës e përgatitën përmbajtjen për mbledhjen e Pragës të ministrave të arsimit, shtetet e të cilëve janë të kyçur në procesin e Bolonjës.

Institutet e larta arsimore e vërtetuan orientimin e tyre për Deklaratën e Bolonjës dhe detyrimet e tyre për formimin e hapësirës evropiane për studime të larta deri në fund të dekadës së parë të shek. XXI. Ata mendojnë se me formimin e asociacionit të universiteteve evropiane në Sallamanka, në realitet jepet një simbolikë dhe një vlerë praktike, e cila do të ndihmojë në efikasitetin e qeverive të tyre si dhe shoqëritë me mbështetjen e së cilave do të formohet e ardhmja e tyre në kuadër të hapësirës evropiane në arsimin e lartë.

PROJEKTE

Në vitin e fundit Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë në FON ka paraqitur disa projekte. Ato në përgjithësi janë të programeve FARE dhe TEMPUS. Për momentin, në vijim është projekti i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare me fondacione të huaja dhe universitete të tjera nga lëmia e të drejtave të njeriut, liria e qytetarëve dhe multikulturës.

Për arritjet në lëmitë e hulumtimeve shkencore dhe të arsimit pra Universiteti FON si institucion ka fituar disa mirënjohje shtetërore, ndërsa disa profesorë të këtij fakulteti kanë fituar mirënjohje më të larta në lemitë e tyre për përsosshmëri individuale.

Në vitin akademik 2008-2009 në këtë fakultet janë realizuar tre projekte kërkimore nacionale me pjesëmarrje të ligjeruesve, bashkëpunëtorëve, posdiplomikëve dhe studentëve edhe atë në keto tema: kultura politike, sistemet politike demokratike, pluralizmi partiak në RM dhe arsimi qytetar.

Me rëndësi të vëçantë është të theksohet se Fakulteti për Shkenca Politike në dhjetor të vitit 2009 nënshkroi kontratë për partneritet me UNITWIN- UNESCO, në bazë të së cilës në përputhje me Fakultetin e Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë në FON në Shkup do të hapet katedra e parë e CHAIR UNESCOS në RM.

ARRITJA E MARRËVESHJES PËR PARTNERITET ME NITWIN/UNESCO CHAIRS PROGRAMME

Kjo kontratë është iniciativë në të cilën janë të kyçur studentët dhe profesorët, si dhe profesorë të huaj, miq, ambasadorë dhe ligjerues me qëllim të realizimit të projektit "multicizmi në arsim- kopadibile me identitetet nacionale ikonografike" edhe atë përmes ushtrimeve, hulumtimeve, gërshetim idesh në nivel akademik si dhe qasje dhe ndarje të informacioneve në nivel të UNESCOS.

Universiteti FON me kualitetet e veta, me kuadër multietnik si dhe me studentë të zellshëm, ka qasje të rëndësishme dhe reputacion ndaj të gjitha universiteteve private në Republikën e Maqedonisë, ka tendenca për punim të qasjeve praktike të më shumë projekteve për përparimin e jetës multietnike në shtet dhe më gjërë. Qëllimi primar është i trashigimisë kulturore-historike të etniteteve në shtetin tonë. Për këtë qëllim do të organizoheshin laboratoriume ku do të punonin së bashku nëpër ekipe bashkësi të etniteteve të ndryshme. Në kuadër të këtij projekti parashihet prezantimi i punimeve më atraktive si dhe analizë kulturore-artistike ose analizë e artefakteve historike të ngjarjeve të dekadave të organizmave sociale dhe të ndryshme. Studentët më të suksesshëm në aktivitetet e tyre do të udhëtojnë në Paris në një vizitë 5 ditore në UNESCO.

Realizimi i mësimit praktik si pjesë e Plan-programit studimor të Fakultetit

Specifika e Fakultetit është në atë se në Plan-programin mësimor, studentët realizojnë mësim praktik në: Ministrinë e Punëve të Jashtme të RM-së, Sekretariatin për çështje evropiane, Ministrinë e Punëve të Brendshme të RM-së, ambasadat e RM-së në vendet e tjera, Këshillin e Qytetit të Shkupit, komuna, në biznes-kompanitë e mëdha, mediat publike, në vetadministrimin lokal etj. Fakulteti ka një eksperiencë pozitive me këto punë praktike.

Është e nevojshme që të potencohet që pjesa më e madhe e studentëve të gjeneratës 2008-2009 që kanë diplomuar në këtë fakultet, tashmë janë të punësuar, ose kanë siguruar bursa për studime pasdiplomike në vend dhe jasht vendit.

Punësimi realizohet pjesërisht në sektorin privat, kurse në pjesën më të madhe në MPJ, Sekretariatin për eurointegrime, në organet qeveritare dhe në organizata joqeveritare, si dhe në institucione të ndryshme nga sektori publik.

AMBASADORËT DHE LIGJËRATAT

Gjatë çdo viti akademik, Fakulteti planifikon mbajtjen e më shumë tribunave, debateve, tryezave të rrumbullakta, ligjërata dhe takime me deputetë, funksionerë publikë, diplomatë dhe ekspertë të huaj në Universitetin FON, me pjesëmarrjen e mediave.
Deri më tani në ligjerim në Fakultet kanë marrë pjesë mysafirë -ligjerues, si dhe ambasadorë nga përfaqësitë diplomatike në RM, mes të cilëve:

FILIP RIKER - ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Maqedonisë

TEMA: Politika e jashtme e SHBA-ve



ERVAN FUERE - amabasador i BE-së në Republikën e Maqedonisë dhe shef i delegacionit të KE në RM;
TEMA: Liberalizimi i vizave

ARFON HAKAN OQALL- ambasador i Republikës së Turqisë
TEMA: Bashkëpunimi midis Turqisë dhe Maqedonisë në fushën e ekonomisë, kulturës dhe arsimit

ARBEN ÇEJKU - ambasador i Republikës së Shqipërisë
TEMA: Diplomacia ekonomike

ULRIKE MARIA KNOTC - ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në RM
TEMA: Kombet dhe kufijtë: Cili është roli i tyre në të ardhmen e Evropës?

SIMONE FILIPINI - ambasadore e Mbretërisë së Holandës në RM
TEMA: Diskutim për realizimin e projektit "Vizitë e selisë së NATO-s" të studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë

ROBERT SIMONS - Ndihmëssekretar i përgjithshëm i NATO-s
TEMA: Sfidat politike dhe të sigurisë

INTERVISTË ME PRODEKANIN E FAKULTETIT TË SHKENCAVE POLITIKE, DIPLOMACISË DHE GAZETARISË, PROF. DR. NAZMI MALIQI

Ne dallohemi me kualitetin arsimor që ua ofrojmë studentëve

Prof.Dr. Nazmi Maliqi është prodekan në Fakultetin e Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë. Doktor i Shkencave Politike, ligjërues i lëndeve Shkenca për politikën, Sistemi politik, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Politika e jashtme dhe Sistemet e sigurisë.

Nazmi Maliqi ka lindur më 18 mars 1957 në fshatin Stançiq komuna e Gjilanit, Republika e Kosovës. Prej shtatorit të vitit 1961 me familjen e tij jeton në Kumanovë.

Profesori Maliqi, studimet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore "Mbrojtja dhe siguria" i mbaroi në Universitetin e Beogradit në vitin 1981. Studimet posdiplomike në lëmin e mbrojtjes dhe studimeve paqesore i filloi në dhjetor të vitit 1994 në Fakultetin Filozofik në Shkup. Temën e magjistraturës "Toleranca politike si faktor i paqes dhe i sigurisë" e mbrojti më 7 korrik 1999. Hulumtimet e doktoraturës i filloi më 5 dhjetor të vitit 2001, në Institutin për Hulumtime Sociologjike dhe Juridiko-Politike në Shkup. Tezën e doktoraturës "Përafrimi i Maqedonisë në NATO", e mbrojti më 4 nëntor të vitit 2003, ku edhe fitoi titullin e **Doktorit të shkencave politike.**

Në Universitetin FON është prej vitit akademik 2005/2006 si profesor inordinar. Lëmi e ngushtë e interesit të tij shkencor janë marrëdhëniet ndërkombëtare, politikat e sigurisë ndërkombëtare, politikat e sigurisë së RM-së, sistemi politik dhe politika e jashtme e RM-së.

Librat e publikuara: Toleranca politike në funksion të paqes, Gjurmë politike, Shpalosje politike, Sistemet e informacionit publik dhe privat (Doracak), Menaxhmenti politik (përkthim adaptim), Përafërimi i Republikës së Maqedonisë në NATO.

Karriera arsimore: Pas diplomimit në shatator të vitit 1981 punësohet profesor në shkollat e mesme të Kumanovës; Në vitet 1982-1983 ishte udhëheqës i përgatitjeve mbrojtëse në Kombinatin e tekstilit "Integj" në Gjilan; Punën e profesorit e vazhdon përsëri në shkollat e mesme të Kumanovës, prej viti 1983 deri në 17 shtator të vitit 1987, kur edhe u diferencua nga pozitat e nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar dhe u përjashtua nga procesi arsimor nga pushteti i atëhershëm, pasi që e kundërshtoi modelin e paraleleve të përziera, ku mësimi duhej të zhvillohej vetëm në gjuhën maqedonase. Pas këtij diferencimi, për të siguruar ekzistencën familjare, Nazmi Maliqi prej 14 qershorit 1988 gjer në 13 prill të vitit 1993 punoi dhe jetoi në Matesburg, në Burgelland të Austrisë.

Karriera politike: Në muajin prill të vitit 1990 ishte ndër themeluesit e PPD-së, kurse në postin e zëvendësministrit të Mbrojtjes në Qeverinë e Maqedonisë, Nazmi Maliqi është zgjedhur më 14 prill 1993. Në këtë post ishte deri më 25 nëntor 1994. Në mandatin parlamentar 1994-1998 është zgjedhur debutet në Parlamentin e Maqedonisë. Gjatë ushtrimit të postitit të deputetit ishte anëtar i Komisionit parlametar për mbrojtje dhe politikë të brendshme, anëtar i Komisionit për kontroll dhe mbikqyrje paralemtare të Drejtorisë së Sigurimit dhe Kundërzbulimit. Në vitet 1996-1998, ishte anëtar i Delegacionit parlamentar të Republikës së Maqedonisë në Kuvendin Parlamentar të NATO-s.

Karriera universitare: Nazmi Maliqi karrierën e ligjeruesit universitar e filloi në tetor të vitit 2002 në Universitetin e Evropës Juglindore, në lëndët: "Studime evropiane", "Sistemet e informacionit publik dhe privat" dhe në lëndën të "Drejtat e njeriut dhe roli i shërbimit publik". Në vitin 2004-2006 e ushtroi postin e drejtorit të Qendrës për Hulumtime në Fakultetin e Administratës Publike. Dy vite ishte anëtar i Senatit në UEJL. Në tetor të vitit 2007, me dëshirën e tij, e nderpreu marrëdhënien e punës në Universitetin e EJL dhe kalon me marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin FON. Profesor Maliqi e udheheq Shoqatën e intelektualeve "Klubi Demokratik"-Shkup, ndërsa është edhe kryeredaktor i revistës për shkencat shoqërore "Vizione", prej shtatorit të vitit 2004.

Profesor Maliqi, në vitet akademike 2006 dhe 2007 ishte i angazhuar si ligjërues në studimet pasdiplomike në UEJL, në lëndët: Analiza e politikes së jashtme e sigurisë (Administratë publike dhe diplomaci), Studimet evropiane të avansuara (Grupi I **PARIS XII & UESE, Administration publique et gestion des collectivites territoriales**), funksionimi i strukturave administrative të UE-së (grupi pasdiplomikëve për administratën krahasuese në UE dhe në lëndën Politikat e sigurisë kombëtare (Administrata publike-Grupi i sigurimit).

Prej tetorit të vitit akademik 2007 vazhdon në kontuinitet të ligjerojë lëndët Sistemet e sigurisë kolektive dhe diplomacia preventive dhe Sistemi i sigurisë nacionale, në studimet pasdiplomike në Universitetin FON në Fakultetin e Shkencave Politike, drejtimi Politika Evropiane dhe ndërkombëtare si dhe në Fakultetin e Detektivëve dhe të Sigurimit.

- Profesor Maliqi, çka ju motivoi që të themeloni marrëdhënie pune në Universitetin FON. A mund ta përshkruani dallimin në programin arsimor, përvojat nga studentët, perspektivat që i ofron Universiteti FON, duke krahasuar sistemin për konkurrencën e vetëshpallur?

Ardhja ime në Universitetin FON ishte një motivim i veçantë që të inkuadrohem në një proces arsimor me perspektiva të reja të një konkurrence reale akademike. Motivim im ishte sidomos niveli i lartë i mirëkuptimit të ndërsjelltë kolegial dhe akdemik që kultivohet në këte universitet, si dhe saktësia programore që u ofrohet studentëve nga Fakulteti i Shkencave Politike. Kuptohet, përvojën e një komunikimi edukativo-arsimor, pedagogjik dhe miqsor që e kisha në pesë vitet e kaluara me studentët e UEJL, po mundohem me përkushtim ta kultivojë dhe ta ruajë edhe me studentët në Universitetin FON.

- Çfarë strukture profesionale plason katedra juaj për sitemin politik të shtetit ose për UE-në. Sa jeni ju të kënaqur si profesor kur informoheni se ndonjë nga studentët tuaj ka arritur më shumë se ju, ka pasur sukses, që i ka realizuar dëshirat e tij?

Gjithsesi, përparimi i çdo studenti të universitetit tonë, në karrierën e tyre profesionale është edhe gëzim i ndërsjellë. Me siguri se kënaqësia ndahet edhe me prindërit e tyre. Mund të them se është edhe gëzim dhe ndjenjë e papërshkruar. Është fat i madh për çdo profesor kur sheh sudentin e tij të dikurshëm si njeri që ndërton vlera afirmuese akademike, kjo do të ishte edhe një kurreshtje për ndërtimin e një kontuiniteti të komunikimit në mes gjeneratave, për ndërtimin e perspektivës arsimore, që të vazhdojnë të hapërojnë me kohën dhe të jenë edhe më konkurrentë. Në kohën e përafrimit të Republikës së Maqedonisë, apo drejt anëtarësimit të plotë në NATO dhe UE, Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë, me përcaktimet programore dhe kulitetin arsimor kadrovik që e posedon, i bën studentët tanë që të jenë në gjendje të ballfaqohen me sfidat profesionale edhe në kuadër të NATO-s dhe UE-së.

- Si e vlerësoni kualitet e studentëve, a ekziston një konkurrencë e heshtur për një sukses më të mirë, a ekziston ndihma e ndërsjelltë nga gjenerata në gjeneratë, a arrijnë kuadro më profesionale dhe më me përspektivë?

Pa dilemë, studentët në rrugëtimin e tyre për studim dhe hulumtim të suksesshëm do ta gjejnë arsyen e tyre të pakontestueshme që të ndihmohen në mes vetes, që ta arrijnë qëllimin e tyre studimor. Kjo mënyrë e bashkëpunimit në mes studentëve, ndihmohet me kontributin e veçantë që japin profesorët, asistentët dhe të gjithë ata që kujdesen për mbarëvajtjen e procesit arsimor bashkëkohor. Ligjeratat, përcjellja e ngritjes apo lëvizjes së studentëve në vlerësimin e diturive akademike, përmes ushtrimeve, detyrave punuese dhe projekteve, si dhe përsosja e programeve arsimore, janë si parakusht që studentët tanë, pas mbarimit të fakultetit të jenë domethënës në karrierat e tyre profesionale.

-Cili është dallimi ndërmjet jush, si fakultet dhe konkurrentëve?

Fakulteti ynë punon në plane aftgjata për kultivimin e një strukture kualifikuese të politikologëve, diplomatëve, gazetarëve, nënpunësve në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore, apo edhe të liderëve të ardhshëm që do të jenë ndikues në ndërtimin e proceseve politike. Dallimi i fakultetit tonë me konkurentët është i dukshëm. Ne dallohemi me kualitetin arsimor që ua ofrojmë studentëve, me shkathtësitë akademike si dhe me strukturën infrastrukturore të përgjithshme që i bëjnë studentët tanë më të përgatitur, më komunikativë, dhe intelektualë më të guximshëm.

-A thua studentët, dhe ju si profesor angazhoheni të jeni para kohës, në kuptim të asaj që të jeni në rrjedha me programet arsimore, që këto kuadro të jenë të arsimuar dhe të jenë të barabartë me kolegët e tyre në UE dhe në vendet e tjera?

Fakulteti i Shkencave Politike funksionon me tërë kompetentësinë universitare për përcjelljen e kontuinitetit të programeve arsimore të unifikuara sipas kartës së Bolonjës. Kuptohet se përcaktimi programor i ofron mundësitë që studentët tanë të jenë pjesë e rrjetit projektues arsimor profesional, që të jenë të përgatitur të konkurrojnë me vlera arsimore me kolegët e tyre në UE dhe në shtet e tjera.

- Si vlerësoni ndihmën tuaj profesionale që do ta ofroni me kuadrin arsimor, a do të ishit të kënaqur të punoni me ata, sa jeni të kënaqur me sistemin organizativ në Universitetin FON si tërësi?

Vendosja sistemore organizative në Universitetin FON së bashku me strukturën akademike të profesorëve, është mënyra e vetme që e garanton arritjen e qëllimeve madhore arsimore. Në Universitet, është e definuar qartë mënyra e ndarjes së të drejtave dhe obligimeve akademike. Është më se e qartë se sukseset në punën universitare mund të arrihen duke e kuptuar detyrën e profesorit si mision në rrumbullaksimin e qëllimeve universitare, gjithëherë duke e rujatur interesin e përbashkët me studentët, që të sëndërtohet qëllimi i ngritjes akademike.

Unioni i Studentëve në Universitetin FON

Unioni Studentëve në FON është themeluar në vitin 2003 dhe njëherit paraqet Unionin e parë në Universitet privat në RM.

Atë e përbejnë të gjithë studentët e Universitetit FON, të cilët në mënyrë demokratike zgjedhin liderin e tyre dhe formojnë organ studentor që do t'i përfaqsojë interesat e tyre dhe do të përpiqet të përmirsojë kualitetin në studime:

- Punon sipas Statutit të miratuar nga organizata studentore dhe në përputhje me të , bashkëpunon në mënyrë të koordinuar me të gjitha sektorët e Universitetit, duke vënë theks të veçantë në aktivitetet si vijon:

-evoluim i studimeve dhe propozime për përsosje të tyre,

-organizimi i garave në mes të studentëve,

-organizimi i aktiviteteve rekreativo-sportive, shoqërim të përbashkët dhe ahengje të ndryshme,

-organizimi i manifestimeve me karakter të artit dhe kulturor,

-sygjerime dhe këshilla në kontekst me përmirsimin e kualitetit të mësimit të cilat janë në interes reciprok për studentët dhe stafin akademik.

US-FON është i ndarë në sektorë të cilët i udhëheqin udhëheqësit e sektorëve (çdo fakultet ka sektorin e vet) aktivitetet e të cilëve kanë të bëjnë me fushën në të cilën studiojnë. Një ndër aktivitetet e para dhe më të rëndësishme është edhe aksioni studentor "VISA NO WAY" ku përveç të shumtëve, një ndër organizatorët ishin edhe Driton Kuçi dhe Altin Kaja, dhe me këtë dëshmuan se zëri i studentit shqiptarë në FON është në nivelin e duhur, pasi që delegacionin nga FON-i për në Bruksel nga gjithsej 4, 2 prej tyre kanë qenë shqiptarë, gjë që tregon për ngritjen e standarteve europiane dhe për prishjen e barrierave mentale brenda përbrenda Universitetit.

Përveç aktiviteteve të shumta që bën Unioni i Studentëve, duhet theksuar edhe vepriminë e fuqishme të shqiptarëve në strukturat e Unionit të Studentëve FON, ku në numrin 2 të kësaj organizate jam unë si zv.kryetar i paraparë sipas Rregullores dhe Statutit të US-FON, duke i gëzuar të gjitha të drejtat dhe duke marrë persipër edhe të gjitha përgjegjësitë që dalin nga Statuti, njësoj si kryetari i Unionit, kolegu Risto.

Vlen për të përmendur se përveç postit të zv.kryetarit në Union, shqiptarët këtu janë të përfaqësuar edhe me kryetar në një nga forumet më të rëndësishme të Unionit, gjegjësisht në Parlamentin ose Kuvendin studentor, ku kryetar i saj është Altin Kaja.

DRITON KUÇI
Zv.kryetar i Unionit të Studentëve të Universitetit të Parë Privat FON

Dhe nga kjo mund të vërejmë se si disa barriera që, de facto, ekzistojnë në shtet, në FON janë shkrirë që nga themelimi i tij, dhe se në FON më nuk flitet për përkatësinë nacionale apo fetare, por në të flitet për nivelin e intelegjencës, për projekte konkrete dhe se si e tillë pasqyron se si duhet të duket një Maqedoni multietnike, dhe me përgjegjësi të lartë mund të themi se Universiteti FON është një Maqedoni në miniaturë.

Ne si zë i studentëve kemi qenë paralelë edhe me situatën reale në RM, duke reaguar dhe shpesh duke ngritur zërin kundër fenomeneve të shumta deviante në shtet.

Vlen të theksohet se Unioni i Studenteve në FON ka marrëdhenie të shkelqyera me shumë unione në Maqedoni dhe rajon, dhe këto marrëdhenie duke i krijuar nga memorandumet e shumta ndër të cilat do ta veçojmë memorandumin e nënshkruar me Qeverinë Studentore të Shqiperisë, Parlamentin Studentor të Universitetit të Prishtinës, Parlamentin Studentor të Tetovës dhe Parlamentin Studentor të UEJL.

Unioni i Studentëve, gjithashtu, ka marrë pjesë në një nga aktivitetet më të rëndesishme në planin e integrimeve, duke qenë organizator të aksionit studentor "VISA NO WAY" dhe duke ngritur zërin për diçka që na bashkon të gjithëve në shtet.

Gjithashtu, duhet mos harruar se në vitin akademik 2009/10 diplomoi edhe gjenerata e parë me studime në gjuhën shqipe nga fakultetet e juridikut, shkencave politike dhe diplomacisë dhe fakultetit të detektivëve dhe sigurimit, të cilët ishin qeliza e parë akademike shqipe në qytetin e Shkupit, e cila u vu në shërbim të të rinjëve shqiptarë falë menaxherëve dhe falë të ndjerit prof. dr. Shaban Prevalla, i cili edhe pse i shtyrë në moshë, nuk kurseu tërë kapacitetin e tij intelektual dhe akademik për të mbajtur në jetë studimet në gjuhën shqipe dhe që 3 fakulteteve të lartpermendura t'i shtojë edhe Fakultetin Ekonomik.

Sot më nuk bëhet fjalë për të mbajtur në jetë studimet në gjuhën shqipe, pasi që 40% e studentëve janë shqiptarë.

Ne si union jemi të përfshirë edhe në Strugë dhe Gostivar ku edhe në këto dy departamente të disperzuara të kemi perfaqsuesit tanë dhe kështu duke e zgjeruar aktivitetin tonë si organizatë studentore.

Vitin e fundit morrëm pjesë në forumet e të rinjve nën udhëheqjen e qytetit të Shkupit ku një numër i madh i OJQ-ve dhe qyteti i Shkupit kemi debatuar për problemet dhe nevojat e të rinjëve.

Të rinjtë deri më tani nëpërmjet OJQ-ve të ndryshme ishin në gjendje për të realizuar nevojat dhe interesat nga më të ndryshmet, në mënyrë që të veprojnë vetëm në kuadër të organizatave, anëtarësisë së saj, dhe një grupi të caktuar të të rinjve.

Me qëllim që të përfshijmë një numër sa më të madh të të rinjëve në nivel të qytetit të Shkupit dhe të mundësojmë një numër sa më të madh të aktiviteteve nga të rinjtë në interes për socializimin, edukimin, arsimimin, ngritjen kulturore, formimin e vetëdijes, si dhe shumë aktivitete të tjera, të cilat i definojnë të rinjtë, është e qartë nevoja për formimin e një strategjie të të rinjve në Shkup. Në këtë kuptim ne e promovuam idenë e formimit të një Federate të të rinjve nga Shkupi (FRSH), qëllimi i së cilës do të jetë puna në nivel lokal, krijimi dhe zbatimi i një strategjie të re, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së të rinjëve në Shkup, për të përfaqësuar interesat e të rinjve në mes moshës 14 dhe 29 vjeç e kështu me rradhë.

Themelues të FRSH janë S4S, US-FON, AISEC, AEGEE, EMSA, IASTE, BEST, BESTEC, KOPRU, HELLSA , HERA dhe BLUE SKX.

Objektivat kryesore të FRSH janë : planifikimin e krijimit të një strategjie të re për të rinjtë në vitin 2010, zbatimin e strategjisë së të rinjve 2011/2016 dhe këshilla për të rinjtë në territorin e Shkupit, duke marrë parasysh se Shkupi është kryeqytet dhe është i vendosur në një situatë të favorshme meqë numri i të rinjëve është në rritje dhe disa faktorëve të tjerë relevantë.

Strategjia e të rinjve do të na krijojë një mundësi që ne si OJQ që punojnë me të rinjtë, të krijojmë një federatë të shoqatave, të cilat do të jenë së bashku të drejtuara për projekte që janë me interes për të rinjtë në fusha të ndryshme, duke plotësuar nevojat dhe mjetet e nevojshme për formimin e të rinjve si ardhmëri e shoqërisë sonë, në mënyrë që edhe të rinjtë e qytetit të përballen me problemet e njëjta si dhe moshatarët e tyre në shumë kryeqendra të Evropës.

Kjo strategji përfshinë problemet në fushën e edukimit dhe trajnimit, qasje në sport dhe rekreim,problemet e transportit, lëvizjes, përdorimin e hapësirës publike, mungesa e institucioneve që mbështesin të rinjtë, mundësitë për praktikë profesionale, vullnetarë dhe më shumë. Strategjia nuk ka për qëllim të kundërshtojë apo të ndryshojë punën ekzistuese në fushën e qytetit të të rinjve, por më shumë për të plotësuar dhe tu bërë edhe më e afërt me të rinjtë dhe për të shtuar risi që do të japin Federata e rinjve të qytetit. Plani vjetor i veprimit ofron një mundësi për qytetin që në mënyrë aktive të angazhohet në aktivitetet e ofruara nga Strategjia si dhe mundësinë që partnerët e tjerë kyç nga organizatat tjera për të kontribuar në realizimin e strategjisë në praktikë. Strategjia e të rinjve në qytet është një pasqyrë e të rrinjve që nga mosha 14-29, aktiviteteve të të rinjve në Shkup, vlersimin e nevojave dhe pytjeve të të rinjve.

Zhvillimi i strategjisë së të rinjve do të mundësojë qytetit dhe të rinjve të cilët janë të anëtarsuar në Federatë që të zhvillojnë partneritet ndërmjet tyre, dhe së bashku të japin prioritet dhe të përgjigjen në pyetjet që janë në interesin e të rinjve nga Shkupi.

Nevoja për strategjinë del nga numri i rritur i pytjeve te të rinjtë dhe nevojat e të rinjve shkupjanë që në vazhdimsi të ketë risi nga secila fushë në jetën bashkëkohore, dhe rritjen e nevojave te të rinjtë që të përcjellin trendet botërore, dhe njëkohësisht të njëjtat nevoja të cilat janë të pamundshme për t'u përgjigjur nga një organizatë e vetme e të rinjve, por përkundrazi nevoja për kuadro nga lëmi dhe fusha të ndryshme që do të bashkëpunojnë për një qëllim të caktuar që të rinjtë t'i definojë si një grup demografik.

Ajo që të rinjtë nuk janë të informuar gjegjësisht familja, statusi social ekonomik, joinformimi i kushtëzuar nga pamundësia për të vazhduar edukimin, strategjia e të rinjve është orientuar në bazë të modelit amerikan për strategji lokale dhe pamundësia e tyre që të përfshijnë të gjithë rininë e qytetit.

Visa?! no way!!!

Në atë periudhë çështja e liberalizimit të vizave paraqiste një temë mjaft sensitive për qytetarët e RM, e posaçërisht për popullatën e re.

Dëshmitarë ishim se edhe pse më 01.01.2008 u bë një lehtësim në liberazimin e vizave, prapë se prap shihej se muri Shegnen akoma ishte një nga problemet kryesore për të rinjtë që të udhëtojnë nëpër vendet e Unionit Evropian, dhe pse ky lehtësim u dedikohej posaçërisht popullatës së re gjegjësisht studentëve.

Kishte shumë shembuj nëpërmjet të cilëve dëshmohej se akoma asgjë nuk kishte ndryshuar, dhe se vazhdimisht implementohej procedura byrokratike e gjatë dhe e stërngarkuar për të marrë vizë.

Të zhgënjyer nga përvoja, shumë studentë, por edhe të rinj të involvuar në sektorin joqeveritar ishin koshientë për vështirësitë e shumta gjatë marrjes së vizave, dhe se ishte shumë rëndë të merrej vizë për më shumë udhëtime.

Në një interval kohor në shtetin tonë, e posaçërisht te rinia vërehej një heshtje pasive për këtë çështje, por edhe pse në heshtje kishte një revoltë tepër të madhe te populata më e re.

Mu për këtë arsye e filluam edhe aksionin studentor të quajtur "VISA NO WAY", për çrrënjosjen dhe për prishjen e murit të Shengenit, ku të rinjtë i treguan qëndrimet e tyre, dhe përcollën porosinë e tyre jo vetëm në Maqedoni, por edhe në qendër të Evropës-Brukselit.

Inciativa filloi më 1 dhjetor të vitit 2008 me nënshkrimin e deklaratës nga ana e të gjitha organizatave joqeveritare dhe unioneve të studentëve të cilët investuan shumë mund në këtë aksion.

DEKLARATA

Muri i ri i Berlinit i quajtur regjim i vizave 18 vjet të plota e pengon popullatën e shtetit tonë që lirisht të udhëtojë në kuadër të Unionit Europian.

Me këtë vendim në mënyrë direkte cenohet, por edhe rënohet e drejta e garantuar e njeriut për lëvizje dhe udhëtim të lirë.

Edhe pse RM bëri orvatje të rëndësishme dhe i plotësoi kushtet e udhërëfyesit për liberalizim të vizave, e dimë dhe jemi dëshmitarë se ne akoma jemi të diskriminuar për sa i takon liberalizimit të vizave.

Dhe përsëri radhë të gjata, turma njerëzish që presin nëpër ambasadat evropiane, dhe përsëri probleme me garancinë, dokumentet e ndryshme, sigurimin, dhe gjithë kjo na bën që të ndahemi dhe të jemi të ndryshëm nga të rinjtë dhe moshatarët tanë të Evropës.

Dhe përsëri jemi qytetarë të rendit të dytë.

Me qëllim që të ngremë zërin kundër byrokracisë evropiane dhe t'i vetëdijësojmë institucionet dhe opinionin europian për problemet me të cilat ballafaqohmi, ne të cilët nënshkruam këtë deklaratë nisëm aksionin studentor "VISA NO WAY".

Qëllimi ishte që t'u dërgohej porosi institucioneve të Evropës dhe atyre të vendit, se studentët dhe të rinjtë duan të udhëtojnë të lirë nëpër shumë vende të Evropës.

Në këtë aksion studentor u bashkuan edhe shumë orgnizata joqeveritare dhe unione të studentëve, lobohej nëpër mediume dhe në FACEBOOK.

Nga 2 dhjetori i 2008-tës filloi edhe mbledhja dhe grumbullimi i nënshkrimeve, ku qëllim ynë ishte që të mblidhen 10.000 nënshkrime dhe këtë edhe ia arritëm.

Pjesa e tretë e protestës ishte protesta në Bruksel.

Duke e falenderuar ambasadorin e Sllovenisë, ekselencën e tij Alan Brajan Bergant kishim takim me ambasadorin e RM në Slloveni, si dhe me perfaqësues të lartë të MPJ të Sllovenisë.

Në Bruksel protestuam dy herë para Komisionit Evropian dhe kemi pasur takime me zyrtarë të lartë të këtij institucioni.

Vlersoj se kjo nismë pati sukses, edhe pse shumë e vogël patëm një imapkt në rrëzimin e regjimit të vizave.

Vlen për të theksuar se në tryezën e rrumbullakët ku merrte pjesë i gjithë kori diplomatik, zv/kryetari i US-FON Driton Kuçi i frymëzuar nga takimi paraprak që bëri me prodekanët shqiptarë të Universitetit FON, mbajti fjalim në gjuhën shqipe ku ndër të tjera, tha: "Këto ditë ne po mundohemi të rrënojmë një mur mental, një barrierë mentale e cila na ndanë në njerëz të mençur dhe jo aq të mençur, në njerëz të emancipuar dhe jo aq të emancipuar, në njerëz të cilët mund të udhëtojnë dhe në njerëz që nuk mund të udhëtojnë, dhe se sa keq është të ndjehesh njeri i rendit të dytë ku të cenohen të drejtat elemantare, dhe se kjo nismë duhet të na shërbejë të gjithëve që me rënimin e kësaj barriere të rënojmë edhe barrierat interne në shtet, dhe se duhet të jemi koshientë se ne nuk jemi shoqëri multietnike, por jemi shtet multietnik, duke mbaruar fjalimin me falenderim të gjithë atyre studentëve që nënshkruan deklaratën, e posaçërisht studentëve shqiptarë të cilët grumbulluan mbi 7.000 nënshkrime". Pas kësaj studentët organizuan tryeza të shumta, dhe merrnin këshilla të ndryshme nga profesorët dhe prodekanët e Universitetit FON, të cilat ishin shumë të nevojshme për studentët e rinj të cilët do të udhëtonin për në Bruksel.

Pas kësaj u forcua lidhja në mes unionit tonë të studentëve dhe OJQ "Të rinj për të rinj" ku dhe u mbajt një tribunë me temë: "Ambasadorët e rinj dhe aktivizimi i tyre në Evropë.

BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE

Studime të përbashkëta postdiplomike në fushën e integrimeve evropiane dhe marrëdhënieve ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar i Fakultetit të Shkencave politike, diplomacisë dhe gazetarisë me Universitete të afirmuara evropiane dhe ndërkombëtare.

Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë pranë Universitetit FON bashkëpunon me universitete të afirmuara prej Evropës dhe SHBA-ve, ndër të cilat: Sektori për politikë publike "Lindon Xhonson" pranë Universitetit në Ostin, Teksas - SHBA, pastaj me Qendrën për studime postdiplomike për politikë publike dhe marrëdhënie ndërkombëtare pranë Universitetit të Pitsburgut, Pensilvani - SHBA. Fakulteti ka vendosur bashkëpunim ndërkombëtar për këmbim me Institutin Evropian për studime të larta ndërkombëtare, në Nicë, Francë, pastaj me Kolegjin Gea të Lublanës, ndërsa në fazë përfundimtare janë përgatitjet për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim me Universitetin e Sorbonës në Paris, Francë si dhe me institucionet e tjera.

STUDIMET POST-DIPLOMIKE DHE DIPLOMA E DYFISHTË

Qëllimi i studimeve postdiplomike është që të aftësojë kuadro të shkallës më të lartë profesionale, akademike dhe shkencore, në nivel të veçantë profesional, shkencor dhe kualitet arsimor, duke zhvilluar dhe aplikuar standardet evropiane dhe botërore të përvetësimit dhe krijimit të diturive: ndër të tjera, kjo do të mundësohet dhe lehtësohet me shfrytëzimin e teknologjive më moderne komunikuese dhe informatike.

Në përgatitjen e elaborateve për studime postdiplomike, Universiteti FON hyri në kontakt me Shkollën për politikë publike 'Lindon Xhonson' pranë Universitetit të Ostinit, Teksas, me Shkollën për studime postdiplomike në sferën e politikës publike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Universitetit në Pitsburg, Pensilvani, SHBA, me Shkollën e lartë për shkenca humane në Pultusk, Varshavë, Poloni, por edhe me Universitetet në Lublanë dhe Maribor, si edhe me Shkollën për studime ballkanike në Universitetin e Çikagos, Ilinois SHBA.

Prej vitit akademik 2010/2011, në procesin arsimor në studimet postdiplomike pranë Universitetit FON do të angazhohen edhe profesorë të shquar nga Instituti Evropian për Studime të Larta nga Nica. Bashkpunimi me këtë institut ndërkombëtarë bazohet në marrëveshjen e nënshkruar me Universitetin FON më 20.06.2008 në Nica të Francës.

Instituti evropian ka qendra për studime të larta në Romë, Berlin, Stamboll dhe në Nicë. Duke u nisur nga ky bashkpunim dhe komunikim, mundësohet ligjerimi i profesorëve eminentë, kërkuesve dhe profesinistëve nga këto universitete dhe akademi në FON. Pjesë e studimeve, seminaret dhe studimet praktike do të realizohen me të ashtuquajturën on-line and distance learning, për të cilën Universiteti FON ka në disponim teknologjinë më moderne.

STUDIME TË MAGJISTRATURËS

Magjistratura është e dedikuar për studentë të cilët veç më kanë diplomë nga shkencat humane, të drejtësisë ose shkencat shoqërore dhe dëshirojnë të specializohen për studime evropiane ose studime ndërkombëtare. Qëllimi i magjistraturës është të përgatiten studentë për t'i kuptuar dhe analizuar ndryshimet politike, sociale dhe shoqërore në Evropë dhe në botë. Njoftim i përgjithshëm i gjendjes momentale ndërkombëtare me gjithë komplekssshmërinë dhe ndërvarësinë do të plotësohet me raste praktike dhe specifike të cilat i simulojnë proceset e vendimmarrjes ndërkombëtare dhe verpimit. Theks specifik i është vënë Evropës Juglindore dhe në tentimet që në këtë pjesë të arrihet stabilitet afatgjatë dhe integrim evropian.

Kualifikimi që fitohet pas kryerjes së studimeve është magjistër për integrime evropiane dhe marrëdhënie ndërkombëtare, 120 ECTS kredi për shkallën e magjistraturës.

PROCEDURA PËR REGJISTRIM DHE PARAQITJE TË MAGJISTRATURËS

Programi është i hapur për kandidatë të cilët posedojnë diplomë universitare nga të gjitha etnitë dhe nga të gjitha profesionet.

Kandidatët duhet të kenë njohje aktive të gjuhës angleze.

Kandidati duhet të dorëzojnë dokumentet si vijon:

-fletëparaqitje

-fotografi e kandidatit me madhësi të fotografisë për pasaportë

-kopje të diplomës universitare dhe transkriptë të notave

-listë të eseve/ kërkimeve të kryera gjatë studimeve

-listë nga tre rekomandime të nënshkruara me emër dhe mbiemër, thirrje akademike, numër të faksit, e-mail

-rezultate të testimit TOEFL nga gjuha angleze.

Kandidatët do të zgjidhen nga bordi i profesorëve të Universitetit FON dhe CIFE-IEHEI.

KALENDARI AKADEMIK

Ligjëratat janë të ndara në tre semestra

-Semestri i parë:
tetor-dhjetor
-Semestri i dytë
janar-mars
-Semestri i tretë
mars-maj

Pas mbarimit të ligjëratave, studentët e shkruajnë tezën e magjistraturës. Teza mbrohet para komisionit të përbërë nga profesorë të Universitetit FON dhe CIFE-IEHEI.

Këshilli arsimor-shkencor i studimeve:

Bashkëkryesues të këshillit janë prof.dr. Aleksandar Nikollovski, rektor i Universitetit FON, prof.dr. Matijas JOP, drejtor i Institutit për Politikë Evropiane, Berlin, Gjermani.

Koordinatorë të studimeve:

Prof.dr. Matijas Vahter, drejtor i Institutit Evropian për Studime të Larta Ndërkombëtare (CIFE/ IEHEI), Nicë, Francë, prof.dr Dimitar Mirçev, udhëheqës i studimeve postdiplomike pranë Universitetit FON, Shkup, Republika e Maqedonisë.

Anëtarë:

Prof.dr. Frederik Lepin, (CIFE/IEHEI), Nicë

Prof.dr. Dagmar Roçes, (CIFE/ IEHEI), Nicë

Prof.dr. Gjorgji Tonovski, FON, Shkup

Prof.dr. Mirko Tripunovski, FON, Shkup

Prof.dr. Nano Ruzhin, FON, Shkup

Vërejtje:Të gjithë profesorët e kyçur në ligjërata kanë të paktën status të profesorëve të çrregullt.

PJESËMARRJE, AFIRMIM DHE MOBILITET TË STUDENTËVE

Lëvizëshmëria e lirë e studentëve, ligjëruesve dhe postdiplomikëve është një karakteristikë e rëndësishme në sferën e studimeve të larta evropiane. Universitetet evropiane tentojnë që të rrisin lëvizshmërinë, si atë horizontale, ashtu edhe atë vertikale. Njëkohësisht potencial i madh zbulohet në kapshmërinë evropiane të lëvizshmërisë virtuale (e shtyrë nga teknologjia informatike), si dhe studimet transnacionale si imperativ i ardhmërisë.

Veçanërisht ka rëndësi shtyrja e studentëve nga dekani dhe bashkëpuntorët e tij për pjesëmarje të tyre në kontinuitet nëpër gara, seminare, tribuna të organizuara nga Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë pranë Universitetit FON si dhe në seminare të organizuara nga organizata qeveritare dhe joqeveritare të brendshme dhe të huaja, ndër të cilat Konrad Adenaur, pastaj Lëvizja Evropiane në Republikën e Maqedonis, gara regjionale në oratori të organizuara nga organizatat e lart-përmendura, e në bashkpunim me GTZ, Këshillin e Evropës, Unionin Evropian si dhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Iniciativa e Fakultetit të Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë, për aktivitet më të madh të studentëve dhe studimeve praktike, solli deri në realizimin e vizitës në Selinë e Aleancës Veriatlantike - NATO në Bruksel, Belgjikë, e cila u realizua në mars të vitit 2010, nën organizim të Sektorit për veprimtari në diplomacinë publike dhe kontakt me shtete të Ballkanit Perendimor në NATO.

Së bashku me liberalizimin e vizave, kjo vizitë parasheh jo vetëm vizitë edukative, por edhe ngritjen e vetëdijës te studentët e rinj për hapjen e dyerve të Unionit Evropian dhe shpirtit të Evropës pa kufij.

Pas kontakteve të realizuara me përfaqësuesin dhe përgjegjësin e Sektorit për veprimtari diplomatike publike dhe kontaktit me shtetet e Ballkanit Perëndimor që janë në NATO dhe për projekte shkencoro-kërkimore z. Rabai Zolt, hasëm në pranim dhe kënaqësi për bashkëpunim dhe realizim të aktiviteteve të parapara.

Ideja për vizitë Selisë së NATO-s nga studentët tuaj është më të vërtetë mundësi e veçantë për çdo të ri. Për këtë qëllim mund të sigurojmë koosponzorim për realizimin e këtij projekti, që nënkupton organizim të plotë, ligjërata dhe program- thotë Zolt, nga sektori i NATO-s për veprimtari publike diplomatike dhe kontakt me shtetet e Ballkanit Perendimor. Në këtë drejtim, pas iniciativës së dekanit dhe kuadrit mësimdhënës të Fakultetit, prej para disa kohe u formua Klubi euroatlantik i të rinjve me seli në Universitetin FON në Shkup, qëllimi i të cilit do të jetë aktiviteti dhe kontaktet e studentëve të rinj (si dhe të profesorëve dhe asistentëve të Universitetit), me NATO-n dhe UE-në, krejt kjo me qëllim të njoftimit dhe promovimit të vlerave euroatlantike.

Në vitin akademik 2009/ 2010 Klubi dhe Fakulteti në përgjithsi realizuan më tepër debate publike, vizitë Parlamentit të RM-së, takime me diplomatë, prezencë në mbledhje publike të Qeverisë së RM-së e kështu me rradhë.

Klubi euroatlantik i të rinjve pranë Universitetit FON organizoi ardhjen e ndihmëssekretarit të përgjithshëm të NATO-s për çështje politike dhe të sigurisë, ambasadorit Bob Simons, i cili e udhëheq ekipin e NATO-s për evaluimin dhe përgatitjen e Maqedonisë për antarësim të plotë në aliansë. Tema e kësaj ligjërate ishte NATO para Samitit të Lisabonës në 2010.

Në periudhën e deritanishme studentët e Fakultetit të Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë kanë marrë pjesë në shumë gara ndërkombëtare dhe kombëtare.

Në garën e vitit të kaluar për oratori e mbajtur me rastin e 'Ditës së Evropës',më 9 maj , në nivel shtetëror dy studentë nga viti i dytë dhe nga viti i tretë i të njejtit fakultet fituan çmimin e parë dhe çmimin e dytë në konkurrencë të studentëve nga të gjitha universitetet e Republikës së Maqedonisë.

UNIVERSITETI FON, SHKUP, REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BASHKËPUNIM ME INSTITUTIN EVROPIAN PËR STUDIME TË LARTA NDËRKOMBËTARE, NICË, FRANCË

Studimet e përbashkëta postdiplomike dhe të magjistraturës nga sfera e integrimeve evropiane dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare janë rezultat i Marrëveshjes për bashkëpunim të këtyre dy institucioneve, Universitetit FON dhe Institutit evropian për studime të larta ndërkombëtare- CIFE-IEHEI, i nënshkruar në Nicë, Francë, në korrik të vitit 2008. Instituti evropian për studime të larta ndërkombëtare është njëra nga shkollat më prestigjioze për studime postdiplomike në Unionin Evropian, e formuar në vitin 1964, me qendra studimi në Nicë, Berlin, Stamboll. Shkolla është në listën e institucioneve arsimore të Komisionit Evropian, Bruksel dhe nën mbikqyrje direkte të punës nga ana e Komisionit.



AGREEMENT ON MUTUAL COOPERATION

SIGNED BETWEEN

First private University FON, Skopje, Macedonia
and
Institut Europeen Des Hautes Etudes Internationales, Nice, France

June 20th, 2008
City of Nice

The First private university FON from Skopje, Macedonia, Vojvodina St. bb, represented by, the Rector of the University prof. Aleksandar Nikolovski, PhD (further in the text: The FON University) and the Institut Europeen Des Hautes Etudes Internationales from Nice, France, avenue des Fleurs 10, represented by the Director of the Institute, prof. Matthias Waechter, PhD (further in the text: The IEHEI) with the aim to develop scientific and other forms of mutual cooperation in higher education according to the mutual interests, their curricula and in accordance with international legal acts from the domain of higher education, signed and ratified by the contracting parties' states, have agreed on the following:

Article 1

The agreement on mutual cooperation confirms the aim of the two higher institutions to establish and develop cooperation in conducting graduate and doctoral studies programs in the field of European studies, International relations, Comparative politics and government and other social science disciplines.

Article 2

The cooperation will primarily be directed at higher level education and training of specialists, experts, research, academic and public administration personnel to be involved in Macedonia's process of euro-integration and accession to the EU.

Article 3

IEHEI and FON will develop and carrie out common programs of postgraduate and doctoral studies in the same academic fields, if such programs are adopted by the Board of Accreditation of the Government.

On the basis of such cooperation and under condition of standard courses and syllabuses, students of FON may obtain dual diplomas or certificates issued by IEHEI as well.

Article 11

The contract has been signed in four identical copies in English. All the copies of this contract have equal legally binding force.

Rector of the University FON

Director of the Institut Europeen Des Hautes Etudes Internationales

prof. Matthias Waechter, PhD

Bursistët

Universiteti Fon edhe këtë vit vazhdon me fushatën "Edhe në Maqedoni mundet", në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe kompanitë e sektorit privat në Maqedoni. Në tre vitet e kaluara, aq sa kohë ka edhe fushata, janë testuar mbi 10.000 shkollarë të mesëm dhe janë ndarë mbi 500 bursa për më të mirët. Sistemi është i rregulluar në atë menyrë që gjatë kohës së studimeve bursistët çdoherë punojnë me mentor dhe dërgohen në trajnime shtesë relevante për fakultetin ku janë bursistë. Në marrëveshje me institucionet dhe kompanitë është vendosur edhe sistem shtesë i mbikqyrjes, që pas mbarimit të studimeve bursistët të mund të sigurojnë edhe vendin e punës. Në fakt, ky është implementim i sistemeve europerendimor ku në çdo kohë kryhet mbikëqyrje intelektuale.

Përvoja e deritanishme e bursistëve të shkencave politike flet për atë se të gjithë marrin aktivisht pjesë në proceset sociale në shtet. Një pjesë e tyre vizitojnë konferenca dhe seminare në qendrat botërore universitare dhe aktivisht janë të kyçur në klube debatuese dhe organizata joqeveritare në shtet.

Nëse ëndrra juaj është diplomacia, atëherë Fakulteti i Shkencave Politike është zgjidhja e vërtetë, ndërsa bursa ju ofron horizonte të reja në fushën profesionale.

Sistemi i aplikimit është i vendosur në internet faqen e Universitetit FON në www.fon.edu.mk. Me një plotësim të thjeshtë të informatave të kërkuara, ju bëheni aplikant për bursë dhe do të kaloni në procesin e testimit i cili është i planifikuar për më 17 dhe 18 prill 2010.

ARTA KURTESHI

Gjithçka filloi kur pashë spotin publicitar të Universitetit FON për mundësinë që u ofronte maturantëve të të gjitha shkollave të mesme në Maqedoni, duke ndarë 50 bursa studimi për më të sukseshmit. Pas entuziazmit që kisha kur u njoha me këtë mundësi pasoi një dyshim në mendimet e mia. A do të mund t'ia dal?

Por çdoherë që shfaqej reklama në television e ndiqja me vëmendje të madhe. Fillova të klikoja edhe në web faqen e universitetit dhe të interesohem për kushtet që ofronte ky universitet, programin e studimit dhe kuadrin mësimdhënës.

Një mundësi e mirë! Pse të mos e provoj?!

Hapa fletën e aplikimit dhe dhashë informatat që kërkoheshin. Fakulteti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ishte drejtimi që më interesontë më shumë, edhe pse kishte dallim të madh me shkollimin tim të mesëm-mediçinën. Por kjo është kjo. Pashë se nuk ishte mjekësia drejtimi që doja dhe u drejtova në studimin e shkencave shoqërore. Ku i dihet ndoshta edhe në diplomaci ndonjëherë do të kem nevojë për shkathtësinë e dhënies së ineksioneve?!

Kalova testin e parë i cili përbëhej nga pyetje të njohurive të përgjithshme, dhe mora të drejtën për t'iu nënshtruar edhe testit të dytë që do të përmbante pyetje nga lëmi i historisë dhe sociologjisë. Dhe filloi koha kur unë çdo ditë kontrolloja web faqen e Universitetit për të kontrolluar rezultatet. Kjo pritje nuk zgjati shumë, sepse stafi punues i Universitetit ishte korrekt dhe i shpejtë, kështuqë një ditë kur hapa faqen www.fon.edu.mk u takova me një befasi tepër të këndshme. Pashë emrin tim në rreshtat ku ishin shënuar emrat e fituesve të bursës së plotë. Ai ishte një moment i madh për mua, një gëzim i papërshkruar dhe mbi të gjitha një krenari dhe vetëbesim sepse isha unë që fitova bursën me njohuritë e mia që ky Universitet m'i vlerësoi. Dhe ndjej po të njejtën krenari edhe sot kur prezantohem si Arta Kurteshi, studente e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare pranë Universitetit FON, universitet i cili po kontribuon në mbajtjen e studentëve të mirë në shtetin e Maqedonisë, duke u ofruar mundësi studimi me sistem europian.

Sot, tashmë jam në mbarim të vitit të dytë të studimeve, përplot me njohuri në lëmin që po studjoj e që më ka ofruar kuadri mësimëdhënës professional i këtij Universiteti, profesorë dhe asistentë që përveç se na pasurojnë me dituri çdoherë kanë vesh për të dëgjuar hallet dhe vështirësitë tona në fakultet dhe jashtë tij. Kjo "jashtë tij" nënkupton mundësitë që ky Universitet na ofron për bashkëpunim me universitete dhe organizata tjera në aktivitete dhe probleme që na preokupojnë si shoqëri në tërësi. Ky është edhe ai plusi i madh që dallon këtë universitet nga të tjerët, mundësia që u ofron studentëve për afirmim në shoqëri dhe ndjesinë e të qenit i nevojshëm për kontribut në shoqëri.

Duke shijuar këto mundësi që më janë ofruar nga Universiteti FON, shpresoj që e sigurt do te eci në të ardhmen dhe do të arrijë kulmin e asaj që quhet sukses.

ILIR ZUKA

Për ngritje intelektuale dhe vetëdijësim parakusht konvencional dhe i domosdoshëm është edukimi profesional efikas. Çdo i ri i vetëdijshëm pa dyshim se duhet ta ketë kuptuar këtë dhe është në kërkim të saj. Duke u mbështetur në përvojën studentore gati njëvjeçare, për mua sinonim i edukimit profesional efikas është Universiteti FON.

Unë jam Ilir Zuka, student i Fakultetit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e parë privat FON. Ideja dhe dëshira për ta filluar karrierën time shkencore, hulumtuese, diplomatike dhe politike në Universitetin FON nuk ishin edhe plotësisht spontane. Ende pa mbaruar viti i fundit i shkollës së mesme unë vendosa që t'i vizitoj të gjitha universitetet në Shkup dhe në rrethinë që të njihem më detajisht rreth metodave të funksionimit të tyre dhe efikasitetin që ato mundësojnë. Në Universitetin FON shkoja që të merrja edhe disa informata shtesë rreth bursave, sepse disa ditë më parë kisha aplikuar për bursë në fushatën "Edhe në Maqedoni mundet". Përveç mikpritjes u impresionova edhe nga kushtet dhe metodat e studimit në këtë universitet. Po ashtu e kuptova që për fitimin e bursës duhet t'i nënshtrohesha testimeve. Testimi i parë më la përshtypje për shkak të qasjeve dhe përshtatjes shumë objektive ndaj njohurive të një nxënësi. Ky testim kishte të bënte me njohuritë e përgjithshme të nxënësve të fituara gjatë shkollimit 4 vjeçar edhe atë kryesisht nga fusha e shkencave shoqërore. Testimi i dytë ishte i orientuar në kulturën e përgjithshme rreth politikës gjegjësisht rreth elementeve konstituive të politikës ku përfshihej një hapsirë e bollshme për prezantimin e opinionit personal të studentit rreth çështjeve politike të vendit. Këtë proces e përmbylli intervista që përfshinte studentët e ranguar më lart gjatë 2 testimeve paraprake, që në fund unë të fitoj të drejtën për studime pa pagesë në fakultetin që unë kisha zgjedhur.

Për nderë të studentëve të rinj në ditën e parë të vitit akademik u organizua edhe një hapje solemne. Dita e parë në fakultet më bëri të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kisha si një student i shkencave politike. Po ashtu e kuptova që kuadri dhe ngritja profesionale e profesorëve dhe asistentëve do të kontribuojë shumë në zgjerimin e diturive të mia dhe zhvillimin e aftësive metodologjike dhe praktike. Mendoj se këtë mund ta dëshmoj çdo student edhe në teori edhe në praktikë. Ato që e bëjnë edhe më atraktiv procesin studimor, janë ligjerata interaktive dhe mundësia e debateve rreth çështjeve të ndryshme shkencore, por edhe nga zhvillimet mbarëbotërore aktuale. Nëse dikush ndjen cenzurë mbi lirinë e fjalës dhe të shprehurit, Universiteti FON është vendi ku ai mund të tejkalojë këtë barrierë. Një rëndësi e veçantë ka pjesëmarrja në ligjëratat që mbahen nga personalitete të shquara të fushës politike e shkencore, si ambasadorë, diplomatë dhe ekspertë, ku horizontet e njohurive të studentëve zgjerohen në drejtime të ndrsyhme. Pra, liria e studentit, që në çdo kohë brenda orarit të takohet me profesorin dhe të kërkojë literaturë, opinion apo edhe njohuri, është edhe prioritet i këtij universiteti. Unë deri tash jam shumë i bindur se u jam afruar synimeve të mia me hapa shumë të shpejtë, dhe kjo falë studimeve kualitative.

Fushatat, trajnimet, seminaret dhe projektet justifikojnë përkushtimin e Universitetit FON për ngritje profesionale dhe intelektuale të kuadrove të reja që në të ardhmën do të jenë edhe liderët e shoqërisë dhe shtetit.Një ndër këto fushata është edhe ajo "Edhe në Maqedoni mundet" që paraqet një mundësi të shkëlqyer të ruajtjes së kontinuitet të kuadrove kualitative.Me të vërtetë studimi në Universitetin FON paraqet privilegj dhe mundësi për realizimin e ëndrrave të çdo të riu për një të ardhme më perspektive dhe më efikase. Këtë po e them duke u nisur nga vetja ime, sepse zgjidhje ime për studim në Universitetin FON asnjëher nuk është vënë në dyshim.

ANA FRANGOVA

Dituria është parakushti kryesor për sukses në jetë. Megjithatë, në ditët e sotme, përveç diturisë, veçanërisht vlerësohet mënyra e shprehjes së diturisë, kërkohen mënyra të reja, jokonvencionale dhe sa më shumë që është e mundur mënyra më kreative dhe inovative për prezantimin e diturisë ose të zgjidhjes së problemeve konkrete. Kur e shikova reklamën modeste, por efektive 'Edhe në Maqedoni mundet', erdha tek ideja të paraqitem për një nga burstat që i jep Universiteti FON. Para së gjithash, për shkak të kurreshtjes. Nuk kisha informata të mjaftuara për këtë Universitet. Në ndërkohë fitova disa inforamta prej mediumeve, por asnjëherë nuk pata bërë ndonjë kërkim më të hollësishëm rreth mënyrës së studimit, rreth kushteve në të cilat mësohet, si dhe të kuadrove mësimdhënës. Rrethi i parë i testimeve më la përshtypje të fortë- të shkëlqyeshme, kushte moderne për realizimin e ligjëratave, organizim në nivel, personel të këndshëm. Rezulatet ishin të shkëlqyeshme pas testimit të parë, por edhe përshtypja të cilën ma bëri Universiteti në shikim të parë, ishin arsyet të vazhdoj edhe në rrethin e dytë të testimit, ku edhe arrita suksesin më të madh dhe pas intervistës që e pata nga ana e dekanit dhe profesorëve tjerë nga Fakulteti i Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë, u rangova e para në listën e fakultetit tim, me më shumë pikë, dhe fitova një nga 50 bursat e programit të Universitetit, të cilat u dorëzuan në ceremoni solemne, e cila u mbajt shpejt pas shpalljes së rezulateve oficiale.

Në periudhën verore, fillova më tepër të hulumtoj për Universitetin FON dhe nga faqja e internetit të këtij Universiteti kuptova shumë informata interesante dhe të dobishme për mënyrën e punës, për profesorët, për kushtet e Universiteti, si dhe për planet për punë. Atëherë kuptova edhe për Unionin e Studentëve pranë Universitetit FON, që me befasoi para së gjithash me kuantitetin e punës së tyre, edhe pse nuk ka histori të gjatë, duke oragnizuar manifestime të ndryshme dhe realizuar projekte të llojllojshme, me çka kontribon në formimin e individëve të suksesëshëm, me karakteristika të përmendura në hyrje. Përshtypje të fortë më krijoi edhe mënyra e organizimit të Universitetit. Për fillim, prej orareve të ligjëratave që u shpallën, si dhe lajmërimet në kohë për të gjithë aktivitetet tjera, shpalljet dhe oraret, si në faqen e internetit të Universitetit, ashtu edhe në 'facebook'.

Ditën e parë në fakultet vërejta edhe diçka tjetër - puna në grupe të vogla, që mundëson fleksibilitet më të madh në ligjërata dhe në ushtrime, ambient i lirshëm në mes studentëve të cilët të gjithë njihen në mes veti, por në të njëjtën kohë dhe ambient më të mirë dhe aktivitet të të gjithëve në ligjërata dhe ushtrime, ku çdokush ka mundësi të shprehë mendimin e vet dhe të marrë pjesë në debate, diskutime dhe biseda, të cilat hapen çdo ditë. U krijuan shumë shoqëri të reja, kolegët ishin të hapur dhe komunikativë dhe bashkëpunimi ynë brenda fakultetit vazhdoi edhe jashtë tij. Kuadri ligjërues u tregua i shkëlqyeshëm. Gjithashtu edhe asistentët, të cilët përveç ligjëratave kualitative i animojnë studentët që t'i shprehin njohuritë e tyre, por edhe t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre.

Thuaj se në të njëjtën kohë me fillimin e semestrit, Unioni i Studentëve të Universitetit FON shpalli ditë të hapur të universitetit, ku të gjithë studentët e rinj të Universitetit patën mundësi të njoftohen me punën e Unionit të Studentëve dhe njëherit të angazhohen në të njëjtin. Me pritën me entuziazëm, fytyra pozitive dhe të motivuara, të cilët edhe më shumë e rritën dëshirën time të bëhem anëtare e Unionit të Studentëve pranë Universitetit FON. Në muajin që pasoi tashmë isha kyçur në aktivitetet e tyre - si përfaqësuese e LS FON, dhe të Universitetit në përgjithsi. Isha pjesmarrëse në projektin 'Be creative, be informative, be active: get outside the box', i cili ishte i organizuar prej 'Erasmus rrjeti studentor në Maqedoni', dhe ishte ndodhi bilaterale e sektorit slloven dhe maqedonas. Për ato 11 ditë punë aktive, zgjidhje problemesh, por edhe kreativiteti në punë paraqet një eksperiencë të jashtëzakonshme, e cila perveç se më mësoi shumë punë, por edhe dituritë e deriatëhershme t'i shikoj nga këndveshtrime tjera, më njoftuan me punën e 'Erasmus rrjetit studentor', që paraqet Lidhje Studentore Ndërkombëtare, me më teper se 340 sektorë, në po aq universitete, në 33 vende të Evropës, ndërsa punon në promovimin e programeve evropiane për lëvisëshmëri të universiteteve evropinae, si dhe socializim dhe adaptimin e studentëve të huaj që vijnë në universitet prej këtyre programeve për mobilitet. Në periudhën që pason, paralelisht me obligimet e mia në fakultet, punova edhe më këtë rrjet studentor, në të cilin përveç mënyrës së punës, më pëlqeu edhe shpirti entuziast i njerëzve të rinj prej të gjithë Evropës, të cilët i këmbejnë idetë e veta me kolegë nga i tërë kontinenti dhe së bashku ponojnë në projekte më të mëdha dhe më të vogla të shtyrë nga motoja: 'students helping students'. Në disa nga ngjarjet ndërkombëtare në të cilat mora pjesë, krijova shumë kontakte të rëndësishme me njerëz nga e tërë Evropa dhe vendosa të vazhdoj të punoj për këtë organizatë, por tani nëpërmes një sektori të veçantë që gjendet në FON. Për atë, me ndihmën e përfaqesuesit nacional të Maqedonisë, të anëtarëve të LS FON, si dhe të administratës së Universitetit, e plotësova aplikimin për sektorin e 'Erasmus rrjeti studentorë' në kuadër të Unionit të Studentëve pranë Universitetit FON. Në 'Platformën e parë nacionale të Maqedonisë', që u mbajt më 20-21 shkurt 2010 në Universitetin tonë, 'ESM Maqedoni' fitoi tre sektorë të rinj, ndër të cilët edhe ESN FON si edhe një sektor në rrjetin e vet ndërkombëtar. Kjo gjithashtu paraqet sukses të rëndësishëm për mua, për faktin se në të gjtha proektet në të cilat kamë marrë pjesë, do të mund t'i punoj në kuadër të sektorit përfaqësuese e të cilit jam, që gjendet në Universitetin tim. Shkak edhe më i madh janë përfitimet që i sjell puna në këtë organizatë ndërkombëtare, kontaktet të cilat krijohen dhe eksperienca që është pa çmim- të cilat dua t'i ndaj me kolegët nga Universiteti im dhe t'u jap informacione të mjaftueshme që të kyçën në aktivitetet e këtij rrjeti, të njoftohen me punën e studentëve në të gjithë Evropën, si dhe të japin kontributin e tyre pasi që kanë dituri, por i nevojshëm është motivimi.

Njëkohësisht vazhdoj të jem pjesë e LS FON, që e kishte rolin kryesor në njoftimin tim me 'Erasmus rrjeti studentor', dhe më përkrahin dhe marrin pjesë në të gjitha aktivitetet që realizohen ose që planifikohen në të ardhmen. Përkrahja e tyre dhe ndihma e tyre në realizimin e këtyre që përmendëm më lartë, janë shumë të mëdha dhe ato me të vertetë paraqesin shembull për punën dhe aktivitetin e një lidhje studentore.

Gjithsesi, rol të rëndësishëm ka Universiteteti FON, që më ofroi përkrahje jovetjake dhe ka mirëkuptim për obligimet që i kam pasur, për çka në të vertetë jam falenderuese. Semestrin e parë e kreva me sukses të shkëlqyeshëm, por njëkohësisht isha aktive dhe e sukseshme dhe jashtë aktiviteteve të fakultetit. Shpresoj se suksesi im do të vazhdojë edhe në të ardhmen, me përkrahje nga Universiteti, Unioni i Studentëve dhe gjithsesi, nga kolegët e mi.

FON Kuadri akademik

Kuadri akademik i Fakultetit të Shkencave politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë është në kontakt të vazhdueshëm si me kuadrin akademik të fakulteteve të tjera në vend ashtu edhe me kolegët nga Fakultetet jashtë vendit siç janë ai në Sorbona- Paris, FSHP në Nicë, FSHP në Valencia, FSHP Lublanë, FSHP nga Ankaraja dhe shumë të tjerë.

Kontaktet permanente me këto institucione, por edhe përvoja e kontakteve me institucionet euro-atlantike, vizita e selisë së NATO-s dhe BE-së nga ana e studentëve, afirmimi i multikulturës përmes krijimit të katedrës së parë të UNESCO-s në shtet në Universitetin FON, mundësojnë përparsi të mëdha në krahasim me mënyrën e organizimit të mësimit dhe jetës akademike të studentëve në fakultetet e tjera konkurrente.

Përbërja e kuadrit akademik është një përputhje e sukseshme e profesorëve të afirmuar dhe me përvojë të gjatë dhe asistentëve të cilët janë në prag të doktorimit.

Pavarësisht angazhimit të tyre të madh, motoja e tyre primare është: ne jemi këtu për studentët, e jo ata për ne. Nga ana tjetër studentët ua kthjnë këtë profesorëve me prezencën e tyre të rregullt dhe masive në orë të mësimit. Gjithashtu drejt këtij bashkëpunimi të ndërsjellë rol të madh luan edhe ambienti bashkëkohor, optimist dhe dhe i pastër ose siç thotë një student - FON është ambient në ngjyrë, derisa në universitetet e tjera ende mbretërojnë ngjyrat bardh e zi.

Hapsira arhitektonike e krijuar në mënyrë perfekte, 30 000 m2 të ndërtesës së universitetit që do të ndërtohet në kampus funksional, e plotësojnë ambientin pozitiv dhe funksional të këtij institucioni arsimor-shkencor.

Këtu mund të përmendim edhe vizitat e shpeshta të përfaqësuesve të përfaqësive diplomatike dhe ambasadorëve të SHBA-ve, Turqisë, Shqipërisë, Serbisë, të ministrave dhe politikanëve të afirmuar, deputetëve e kështu me rradhë.

Pasqyra e parë pozitive për diplomatët e huaj dhe funksionarët vendor është shpirti i bashkësisë dhe multietnicitetit në Universitetin FON dhe në Fakultetin për shkenca politike, diplomaci dhe gazetari.

Të mos harrojmë edhe organizatat e studentëve dhe të rinjëve. Klubi Euro-atlantik i studentëve të FON-it, Fondacioni Manfred Verner të studentëve të Universitetit FON, Katedra multietnik e UNESKO-s, Klubi i politikologëve-diplomatëve të rinj etj.

Atëmosferë të ngjajshme kemi edhe në fakultetet- departamentet në Strugë, Gostivar dhe Strumicë.

Familja e Universitetit FON po zgjerohet si një brend i llojit të vet në të cilin përparsinë e ka studenti.

PROF. DR. ZEQIRJA IDRIZI

Profesor në Fakultetin e Shkencave Politike, Diplomacisë dhe Gazetarisë në Universitetin FON. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi është punësuar në këtë Universitet edhe me vendimin e komisionit recenzues. Nga viti 2005 është profesor në lëndët Integrimet Europiane, Institucionet dhe Politikat e BE-së, Historia e Diplomacisë, Historia Politike Bashkëkohore, Konfliktet Etnike dhe Historia e Civilizimeve (F. Juridik).

Në studimet posuniverzitare ligjëron lëndën Historia Politike Bashkëkohore- Doktrinat.

Aktivitetet hulumtuese shkencore?

Aktiviteti hulumtues shkencor i prof. Idrizit fillon që si asistent i viteve 94-95 që me themelimin e Universitetit të Tetovës, përkrah prof. dr. Masar Kodrës. Në vitin 1998 prof. Idrizi zgjidhet shef i Katedrës së historisë, ndërsa nga viti 2000 deri në vitin 2005 dekan i Fakultetit Filozofik pranë UT-së, ku njihet edhe si themelues i Fakultetit të Psikologjisë dhe Fakultetit Filozofi-Sociologji në kuadër të Fakultetit Filozofik. Nga viti 2009/2010 është **përgjegjës** i Universitetit FON departamenti në Gostivar.

Prof. Idrizi ka të botuar mbi 50 punime nga të cilat 2 monografi (libra), mbi 20 punime shkencore, pastaj kritika, polemika, pjesëmarrje në debate dhe punime tjera të botuara në Shqipëri dhe Kosovë e kështu me rradhë. Ndër to dallojmë këto punime shkencore: Pozita e shqipëtarve në RM pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe punimet shkencore mbi diplomacinë europiane, personalitetet më me peshë të trevës së Pollogut ku do të veçojë Memet Derallën si ministër i Mbrojtjes Kombëtare në Qeverinë e Ismail Qemalit. Po ashtu do të potencoja edhe Tajar Bej Tetovën, të gjithë këta u bënë objekt i raporteve të konzujve të ndryshëm europianë (austriakë, bullgarë, francezë, italianë, turq, sërbë dhe rusë). Nga të gjitha këtë kostelacione që unë elaborova, gjatë punës sime në FON, studentët kanë në dorë librat e autorizuara nga Këshili shkencor- mësimor, "Historia e diplomacisë" dhe "Integrimet europiane, historia, politika dhe perspektiva".

Karriera profesionale

1996-Asistent në Universitetin e Tetovës në lëndën: Historia e popullit shqiptar III.

1998-Ligjërues në lëndën Historia-gjeografike, Historia e popullit shqiptar I dhe Historia e popullit shqiptar III.

1998-zgjidhet shef i Katedrës së historisë.

2000-2005 Dekan i Fakultetit Filozofik në UT

2006-Profesor në Universitetin "FON" në Shkup, ligjërues i lëndës: Historia e diplomacisë: Integrimet europiane-institucionet, politika dhe perspektiva; Integrimet euroatlantike.

2007/2008 në studimet posdiplomike lëndët: Diplomacia, praktika dhe teoria dhe Historia politike bashkëkohore.

Krijimtaria artistike

a. Gjatë periudhës prill-maj 1989 ishte pjesëmar-

rës në zbulimet arkeologjike në F. Gradec së bashku me ekipin e Institutit Arkeologjik të Shkupit ku u zbuluan 13 varreza të shekullit III të erës së re të cilat i përkasin kulturës dardane.

b. Gjatë periudhës mars-qershor 1994 ishte pjesëmarrës në përgatitjen e Simpoziumit Shqiptarët e Maqedonisë, bashkë me prof. dr. Masar Kodra dhe anëtarët e tjere të këshillit.

c. Gjatë vitit 1998 bashkë me prof. dr. Masar Kodra organizuan Sumpozium 90-vjetori i Kongresit të Manastirit në Gostivar.

d. Më 25 nëntor 2002 ka referuar në temën: Roli i Mehmet Pashë Derrallës në shpalljen e pavarësisë, në Prishtinë në organizim të Institutit të Historisë

Më 27 nëntor 2002 ka marrë pjesë në Sesionin shkencor të Institutit të Historisë, Tiranë, me temën: Derrallët në Lëvizjen Kombëtare deri në shpalljen e pavarësisë.

Më shtator 2003 ishte pjesëmarrës në Simpoziumin shkencor në Strugë, në organizim të Shoqatës së Historianëve Shqiptarë, me punimin: "Pjesëmarrja e shqiptarëve të Pollogut në Kryengritjen e shtatorit dhe hakmarrja e ushtrisë serbe ndaj pjesëmarrësve të kryengritjes-Masakra e Gradecit.

Botime

Libri I: "Pozita e shqiptarëve në Maqedoni pas Luftës së Dytë Botërore", Tetovë 2003.

Libri II: "Treva e Pollogut në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1899-1913", Tetovë 2007.

Libri III: "Diplomacia", Shkup 2008

Ligjërata të autorizuara nga lënda: Integrimet evropiane-politika dhe institucionet

Botime në revista shkencore:

Mehmet Pashë Derralla - Ministri i parë i ushtrise kombëtare, "Gjurmime albanologjike Seria e shkencave historike" 28-29,1998-1999. fq. 167-182, Prishtinë.

Ligjërata të autorizuara: "Gjeografia-historike"

Është pjesëmarrës i hartimit të librit "Gradeci ", Tetovë 1995 fq. 10-22, dr.Musa Kraja-dr. Sejfedin Haruni.

Masakra e Gradecit, Revista "KOSOVA", 22/23, Prishtinë, 2003.

Roli i Mehmet Pashë Deralles në shpalljen e pavarësisë, "Kosova", 24/25,Prishtinë, 2003.

Shpërnguljet shqiptare në trojet etnike, "UNIVERS", Tiranë, 2003.

Shqiptarët e trevës së Pollogut gjatë Kryengritjes së vitit 1912, "JEHONA E RE" 3-4/2006, Shkup.

Jehona e Lëvizjes Shqiptare të Pejës në Pollog, "Vizione" nr. 9, Shkup, 2007.

Tajar bej Tetova në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, "Vizione" nr. 10, Shkup 2008.

Diplomacia europiane dhe Tajar bej Tetova ,"Vizione" nr. 11, Shkup 2009.

Nga Shkupi deri në Vlorë, "Vizione" nr. 13 - 14, Shkup 2010.

Prof. Idrizi si profesor i historisë së diplomacisë së fuqive të mëdha, a mund të na bëni një rikapitulim të përgjithshëm të programit arsimor në FON, si dhe një korelacion me studentët dhe kualitetin e tyre?

Dëshira për njohuri më të mëdha dhe solide, si dhe afirmimi vetanak, gjykoi që kjo sfidë i takon brezit të ri të cilët ardhmërinë e tyre e kanë gjetur në Universitetin më të afirmuar, Universitetin FON. Në këtë institucion arsimor, sipas bindjes sime, ata shohin perspektivë dhe kualitet, e këtë më së miri e vërtetuan me disperzimin e Universitetit FON në Gostivar dhe Strumicë. Ky Universitet sfidoi duke regjistrur 190 studentë në 5 fakultete, siç janë Shkencat Politike, Shkencat Juridike, Fakulteti për Informatikë dhe Teknologjitë e Komunikimit, Fakulteti për Detektivë dhe Siguri dhe Shkencat Ekonomike. Kjo do të thotë se rritja e interesit të studentëve tregon që Universiteti FON ka vlera të mëdha në aspektin arsimor-shkencor, kjo vjen nga bashkëpunimi i shkëlqyer i profesorëve, asistentëve dhe administratës, si dhe bashkëpunimi mes tyre. Këtë të fundit e potencoj për arsye se ne llogaritemi si një institucion multietnik dhe me një komunikim të shkëlqyer që do të thotë se studentët nuk përfitojnë vetëm në njohuri, por në ngritjen dhe zhvillimin e procesit edukativo-arsimor dhe atij shkencoro-shoqëror. Kujdes të veçantë Universiteti FON u kushton ngjarjeve aktuale të cilat analizohen, veçanërisht perspektivat dhe parashikimet e së ardhmes. Në këtë mënyrë i motivojmë studentët me qëllim që jo vetëm të marrin njohuri, por të ndërtojnë edhe qëndrime, të zhvillojnë kreativitetin dhe mendimet, për të tanishmen dhe të ardhmen.

Me këtë përfundimisht afrohemi me studimet evropiane, si dhe studentët tanë arrijnë kualitetin dhe profesionalizmin i cili kërkohet në diplomaci. Në aspektin e përgjithshëm, mësimi zhvillohet shkëlqyeshëm falë Kartës së Bolojnës, e cila kartë na sjellë vetëm rezultate pozitive në aspektin arsimor.

ASISTENT MR. SHPENDIM HOXHA

Departamenti i shkencave Politike

Shpendim Hoxha
Doktorant i Universitetit të Vjenës - Austri

Departamenti i Shkencave Politike në Universitetin FON trajton profesionalisht një fushë shumë të rëndësishme të dijes, në zhvillimin e aftësive teorike dhe shkathtësive profesionale dhe praktike të studentëve. Kjo dije e studentëve është e lidhur ngushtë me zhvillimin e mendimit dhe filozofinë politike, në mendimin politik bashkëkohor dhe politikën krahasuese, me teorinë dhe praktikën e shtetit, si dhe me institucionet politikëbërëse.

Programet e lëndëve u krijojnë mundësi studentëve të kuptojnë thelbin e marrëdhënieve në fushat politike, të njohin aktorët në politikën botërore, të mësojnë mbi konfliktet ndërkombëtare dhe politikat e sigurimit dhe pikërisht mbi këtë bazë të marrin mendime politike në interes të zhvillimit dhe sigurimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

